



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivered	03.03	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojcë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHUK	1149/2022		114	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.71/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.71/2022 të datës 28.01.2022, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ në Komunën e Hanit të Elezit, kundër masës disiplinore Vërejtje me Shkrim të datës 12.01.2022 të shqiptuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje me shkrim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 03.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr. 71/2022 e datës 28.01.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II.SHFUQIZOHET Vendimi me numër 03/Nr.368/2022 i datës 28.01.2022 i Komisionit të Ankesave të Komunës së Hanit të Elezit.
- III.ANULOHET masa disiplinore “Vërejtje me Shkrim” me Nr. 03/255/2022 e datës 12.01.2022 e nxjerr nga Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit.
- IV.OBLIGOHET Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Hanit të Elezit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nda dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi dhe të bëjë shuarjen e masës disiplinore të ankuesit nga dosja personale.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas shkresave të lëndës në Komunën e Hanit të Elezit në pozitën “Udhëheqës i Njesisë së Autoparkut”, Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme e Komunës së Hanit të Elezit më datë 12.01.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje me Shkrim”.

Fillimisht ankuesi kundër kësaj mase më datë 17.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në Komunën e Hanit të Elezit, ndërsa më datë 28.01.2022 me numër 03/Nr.368/2022 ka nxjerr vendim me të cilin ka Refuzuar ankesën e ankuesit, pastaj më datë 28.01.2022 fizikisht ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 386/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Hanit të Elezit, ndërsa me datë 18.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Hanit të Elezit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me nr. prot:386/2022 të datës 28.01.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim të datës 12.01.2022; E-mail nga D.S. për Ankesakpmshck i datës 03.02.2022; Parashtresë e datës 02.02.2022; Vendimin me numër 03/Nr.368/2022 e datës 28.01.2022 i Komisionit të Ankesave të Hanit të Elezit; E-mail nga D.S. për Ankesakpmshck i datës 03.02.2022; E-mail nga S.B. për D.S. i datës 02.02.2022; Shkresë nga e muajit Janar 2022; Urdhër për shfrytëzimin e automobilit të udhëtarëve për punë zyrtare i datës 06.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike i datës 25.11.2021; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Udhëheqës i njesisë së Autoparkut”; Kontratë Pune për kohë të pacaktuar me numër 02/1690/2015 i datës 12.02.2015; Ankesën me numër 03/368 e datës 17.01.2022 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.02.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 842/2022 e datës 18.02.2022; Fotografi e datës 07.01.2022; Deklaratë e datës 02.02.2022; Vendimin me numër 02nr.1120/2022 i datës 15.02.2022 mbi deklarinimin e statusit të nëpunësit; Akt Emërimi me numër 02.nr.8342/2012 i datës 13.11.2012;



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedurë, konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e bazuar, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në KPMSHCK, pretendon që masa disiplinore “vërejtje me shkrim” e shqiptuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Hanit të Elezit është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk ka këshillë juridike, dhe është tendencioze; sepse shpërndarjen e kalendarëve e kam bërë nga mirëbesimi jo që e kam pasur në përshkrim të detyrave të punës, sepse fjala është që gjatë shpërndarjes së kalendarëve për festat e vitit të ri ankuesi ka lënë të hapur derën e veturës.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës konstaton se ankuesit me datë: 06.01.2022 nga ana e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme i është kërkuar që të bëhet shpërndarja e kalendarëve, gjatë kryerjes së punës së kërkuar nga ana e mbikëqyrësit ankuesi ka lënë derën e veturës së hapur në autoparku, prandaj Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, ankuesit i ka shqiptuar vërejtje duke konstatuar se ka bërë veprim të dëmshëm dhe në kundërshtim me ligjin.

Kolegji, konstaton se Drejtoria e Administratës së Përgjithshme me këtë rast nuk ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike gjegjësisht nenin 45 i cili përcakton se : 1. *Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”, gjegjësisht nuk ka arritur të konstatoj se ankuesi me veprim ose mos veprim cilin dëm ia ka shkaktuar institucionit respektivisht Komunës së Hanit të Elezit, *sepse* mos mbyllja e derës së veturës në autopark nuk ka shkaktuar ndonjë dëm dhe si e tillë nuk është e paraparë si shkelje disiplinore.*

Prandaj Kolegji konstaton, se ankuesi qoftë me veprimin e tij ose mos veprimin nuk ka shkaktuar asnjë dëm ndaj institucionit të Komunës së Hanit të Elezit, kështu që “vërejtja me shkrim” është në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë.

Meqenëse ankuesi më datë 03.02.2022 ka plotësuar ankesën e datës 28.01.2022 duke e dërguar Vendimin me numër 03/Nr.368/2022 të datës 28.01.2022 të Komisionit të Ankesave të Komunës së Hanit të Elezit me të cilin është refuzuar ankesa e tij, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk ka paraparë Komision të Ankesave për nëpunësit civil por vetëm për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës, në këtë rast me që ankuesi është nëpunës i shërbimit civil, ky komision nuk ka pasur kompetencë të trajtojë këtë çështje juridike, si i tillë është në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.71/2022

Çlirim ZEKA  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

